

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË
Nr. 625 REP. Nr. 258 KOL.



KONTRATË SHIT-BLERJE KUOTASH

Sot, në Tiranë, më datën 11/07/2016 (dymijë gjashtëmbdhjete) para meje noteres Sofika K. Braka, notere pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë Rr. "Ismail Qemali" pallati 11/1, Tiranë u paraqitën personalisht:

SHITËSI : Znj. Anna XHEKA me numër personal të dokumentit të identifikues (leternjoftim) H05223055G, ortake e 100% të kuotave të Shoqërisë "ENERGY ALBANIA GROUP" sh.p.k, më poshtë (EAG) pajisur me NIPT L01718504C, me adresë : Shtëpi Private Rrashbull Durrës, referuar më poshtë si: **SHITËSI**

BLERËSIT : 1. Shoqëria "Ghiggia Ingegneria d' Impianti", S.r.l, e regjistruar si person juridik me Kod Fiskal 08267980012 , adresa Rruga „Romano –Montalenghe, 35 -10010 Scramango – Torino- Itali, përfaqësuar nga administratori i saj Z. Stefano Ghiggia me Nr personal pasaporte YA7340311

2. Shoqëria "ETRA" S.r.l, e regjistruar si person juridik me Kod Fiskal 03288000270 dhe adresë „Calle Seconda II del Campellio, 7 , 30026 Portogruaro Venecia, përfaqësuar nga administratori i saj Z. Stefano Urbani, me nr personal Dokumenti Identifikimi; AV 4590361, referuar më poshtë si pala **BLERËSE/BLERËSI**

Personat e mësipërm janë madhorë dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për të cilët, me vullnetin e tyre të lirë bëjnë këtë redaktim e kontratës së shit blerjes së kuotave, me kushtet e mëposhtme:

KUSHTE PARAPRAKE

Shitësi është ortak i vetëm i shoqërisë "ENERGY ALBANIA GROUP" sh.p.k, e cila nga ana e saj po ashtu është ortak i vetëm me 100% të kuotave në shoqërine koncesionare "MP-HEC" sh.p.k e regjistruar në Qendrën Kombetare të Regjistrimit me NIPT K93826001D, datë 23.02.2009 si detyrim i kontratës së koncesionit e formes BOT nr. 311 Rep., 45 Kol., datë 02.02.2009.

Me vendimin e datës 30.05.2016 të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve, është vendosur miratimi i shitjes së 90% të kuotave të kapitalit që Znj. Anna XHEKA ka tek shoqëria "ENERGY ALBANIA GROUP" shpk, në favor të blerësve

1. Shoqërisë "Ghiggia Ingegneria d' Impianti", S.r.l, 45% të kuotave
2. Shoqërisë "ETRA" s.r.l, 45% të kuotave

Ndërkohë që Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë "Ghiggia Ingegneria d' Impianti", S.r.l shpk, ka miratuar me vendimin datë 21.04.2016 blerjen e 45% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë "ENERGY ALBANIA GROUP" sh.p.k, nga zotëruesja e tyre Znj. Anna XHEKA.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë "ETRA" s.r.l shpk, ka miratuar me vendimin datë 18.03.2016 blerjen e 45% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë "ENERGY ALBANIA GROUP" sh.p.k, nga zotëruesja e tyre Znj. Anna XHEKA.

Sa më sipër parashtruar, palët, në cilësinë e tyre, lidhin këtë kontratë me kushtet që vijojnë:

NENI 1

Objekti


Objekti i kësaj kontrate është shit – blerja e 90% kuotave të kapitalit të shitësit.

NENI 2

Çmimi i Kuotave

2.1.a Çmimi i shitjes së kuotave në fjalë, do të jetë në vlerën e tyre nominale, 90 000 (nëntë dhjetë mijë) lek, shumë e cila do të paguhet në llogarinë bankare të caktuar nga shitësi, përkatesisht 1/2 e vlerës nga secili prej blerësve. Me kryerjen e pagesës së çmimit pala blerëse, do të zotërojë 90% të kuotave të shoqërisë, përkatesisht 45% të kuotave do të zotërohen nga shoqëria "Ghiggia Ingegneria d' Impianti", S.r.l, dhe 45% të kuotave do të zotërohen nga shoqëria "ETRA" s.r.l . Shitësja do të vijojë të zotërojë 10% të kuotave të shoqërisë, pa patur asnjë detyrim për kontribut financimi ortaku .

2.1.b Pavarësisht kalimit të kuotave pala blerëse, koncensionari "EAG" sh.p.k dhe shoqëria koncensionare "MP-HEC" sh.p.k, kanë detyrimin të paguajnë (pala shitëse, apo trashëgimtarët e saj ruajnë të drejtën që të përfitojë) në shtatë vitet e para të funksionimit të HEC-it, 4.4 % të vlerës neto të energjisë së faturuar, (faturës mujore të energjisë së prodhuar pa TVSH) të prodhuar nga hidrocentralet



"Niçe", objekt i i kontratës së koncesionit e formës BOT nr. 311 Rep., 45 Kol., datë 02.02.2009 dhe duke filluar nga viti i tetë e në vijim 10,4% të kësaj vlere. Kjo e drejtë e palës shitëse është e pa-limituar në kohë dhe shtrihet përgjatë gjithë kohës se ekzistences se HEC-it, dhe në çdo rast jo më pak se 28 vjet nga momenti i funksionimit, përjashtimisht, kur si rrjedhojë e një force madhore, apo shkakut që nuk varet nga blerësit apo zotërues të tjerë ligjore të kuotave objekt i kësaj kontrate, bëhet i pamundur ndërtimi dhe/ose funksionimi i tij, por jo në rastin kur edhe pse shkaqet, nuk lidhen me vullnetin apo pakujdesinë e blerësit, mund të ishin shmangur nga ky i fundit, nëse do të kishte treguar kujdes maksimal, në menaxhimin dhe funksionimin e HEC-it. Në rast të situatës së mësipërme përjashtimore, blerësi është i detyruar të kërkojë dëmshpërblim nga palët e treta shkaktoare, dhe shitësi përfiton pjesën e tij proporcionale nga dëmshpërblimi, në përputhje me parashikimet e kësaj dispozite, në momentin e marrjes së këtij dëmshpërblimi. Nga vlera e dëmshpërblimit do të zbriten proporcionalisht në raport me pjesën takuese të shitësit, shpenzimet e kryera, për përfitimin e këtij detyrimi, vetëm për atë që janë ngarkuar shoqërive, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Blerësit, dhe në vijim shoqëritë "EAG" sh.p.k., "MP-HEC" sh.p.k., do të zhvishen nga çdo detyrim përkundrejt shitësit, në rast se në përfundim të afatit 28 vjeçar të vlefshmërisë së kontratës së koncesionit e formës BOT nr. 311 Rep., 45 Kol., datë 02.02.2009, HEC do ti transferohet shtetit.

Në rast se në përfundim të afatit 28 vjeçar, blerësve do tu ofrohet nga shteti mbajtja e koncesionit, shitësi do të gëzojë të gjitha të drejtat e njohura në këtë dispozitë, për atë kohë sa do të ekzistojë HEC-i. Në rast se, në përfundim të afatit 28 vjeçar, shteti do tu ofrojë blerësve, mbajtjen e HEC-it përkundrejt kryerjes së një pagese, znj. Anna Xheka, apo çdo i tretë që përfiton këto të drejta prej saj do të jetë i detyruar që të paguajë 10% të vlerës, për llogari të shtetit, në të kundërt do të humbasë të drejtat që rrjedhin nga neni 2.1.b i kësaj kontrate. Pala shitëse, ka të drejtën që të zgjedhë nëse vlerën 10 % (pjesën e saj takuese) do ta kryerjë menjëherë apo do kjo do ti mbahet nga të drejtat që rrjedhin nga neni 2.1.b i kësaj kontrate. Në rast se pala blerëse nuk është e interesuar që në përfundim të afatit 28 vjeçar, të mbajë përkundrejt pagesës/detyrimit ndaj shtetit, HEC-in " Niçe", kjo e fundit ka detyrimin që t'ia ofrojë kuotat e shoqërisë MP-HEC sh.p.k., shitëses Anna Xheka ose palëve të treta të mundëshme, mbajtëse së drejtës sipas nenit 2.1.c të kësaj kontrate.

2.1.c E drejta e palës shitëse për të përfituar vlerën e energjisë së prodhuar, sipas parashikimeve të pikës më sipër, është një e drejtë e trashëgueshme, e

transferueshme tek të tretët. Pala blerëse dhe shoqëritë "EAG" sh.p.k., " MP-HEC" sh.p.k ja njohin palës shitëse këtë të drejtë, marrin përsipër përmbushjen e saj, dhe në çdo rast garantimin e saj sipas parashikimeve të kësaj kontrate.

2.1.d Pala blerëse, dhe shoqëritë mbajtëse të detyrimit në vijim, "EAG" shpk dhe "MP-HEC" sh.p.k, për ti garantuar palës shitëse respektimin e kësaj të drejte, kanë detyrimin që brenda 10 ditëve nga momenti i regjistrimit të kësaj kontrate në QKR, të mbledhin Asamblëtë e Ortakëve të Shoqërisë, dhe të marrin vendim për nënshkrimin e kontratave respektive të detyrimit, ti nënshkruajnë këto kontrata me të njëjtat kushte të kësaj kontrate, për njohjen dhe transferimin e detyrimeve të kësaj kontrate, tek shoqëria "Energy Albanian Group" sh.p.k dhe në vijim tek shoqëria "MP-HEC" sh.p.k., e cila do të jetë shoqëria finale që do ti përmbushë ato. Në të kundërt pala shitëse me një njoftim drejtuar blerësit, ka të drejtë të bëjë anulimin e menjëherëshëm të kësaj kontrate dhe pala blerëse detyrohet të paguajë dëmin e shkaktuar.

2.1.e Secila nga palët kanë respektivisht të drejtën dhe detyrimin që të bëjnë regjistrimin e këtyre të drejtave të shitësit të njohura me këtë kontrate, dhe në vijim me kontratat e detyrimit që do të nënshkruhen me shoqëritë "EAG" sh.p.k. dhe "MP-HEC" sh.p.k., në regjistrin e Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit të biznesit (QKR), tek të dhënat e shoqërisë "EAG" sh.p.k dhe "MP-HEC" sh.p.k . Detyrimet e kësaj kontratë, veçanërisht ai që rrjedh nga neni 2.1.b, është një detyrim që mbartet në çdo rast të tjetërsimit të kuotave të shoqërisë koncensionare "MP-HEC" sh.p.k apo të koncensionarit "Energy ALBANIA Group" shpk, tek palët e treta. Çdo lloj marrëveshje apo tjetërsim që nuk respekton detyrimin si më sipër është e pavlefshme.

2.1.f Të drejtat e palës shitëse që rrjedhin nga kjo dispozitë, neni 2.1.b, lindin me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe bëhen efektive nga momenti i fillimit të prodhimit të HEC-it. Për efekt të kësaj kontrate, si moment i fillimit të prodhimit të HEC, do të konsiderohet lëshimi i faturës së parë , për shitjen e energjisë elektike.

2.2.a Me regjistrimin e kontratës në regjistrin e QKR-së dhe kalimin e kuotave në emër të palës blerëse, kjo e fundit, merr përsipër shlyerjen e debitit të "MP-HEC" sh.p.k., në vlerën e 250 000(dyqind e pesëdhjetë mijë) Euro, duke marrë vetë përsipër pagesën e komisioneve të nevojshme bankare. Shuma prej 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) Euro, do të derdhet reciprokisht, 1/2 nga blerësi, shoqëria "Ghiggia Ingegneria d' Impianti", S.r.l, dhe 1/2 nga blerësi

shoqëria "ETRA" s.r.l. në llogarinë e shoqërisë "EAG" sh.p.k. Në vijim kjo shumë do të transferohet në llogarinë e shoqërisë koncensionare "MP-HEC" sh.p.k, me qëllim që kjo e fundit të likujdojë detyrimet hua që ka marrë nga të tretët, për kryerjen e punimeve të deritanishme në hidrocentralin "Niça", objekt i i kontratës së koncesionit e formes BOT nr. 311 Rep., 45 Kol., datë 02.02.2009. Kryerja e të gjitha transaksioneve bankare, do të bëhet nga Znj. Anna Xheka, e cila është edhe administratore e shoqërive.

2.2.b Kryerja e kësaj pagese, në llogarinë e shoqërisë "EAG" sh.p.k., transferimi i saj në llogarinë e shoqërisë "MP-HEC" sh.p.k., dhe përdorimi i saj, për shlyerjen e borxheve që rezultojnë në bilancin e shoqërisë "MP-HEC" sh.p.k përbën kusht thelbësor të kontratës. Mos plotësimi i këtij kushti, i jep të drejtë shitësit që të bëjë anulimin e menjëherëshëm të kësaj kontrate, si dhe aplikimin e penaliteteve të parashikuara më poshtë, në këtë kontratë, në lidhje me vonesat në përmbushjen e detyrimit, si dhe pagesën e dëmit të shkaktuar.

2.3.a Me marrjen e lejës së shfrytëzimit të HEC-it, shitësi do tu kalojë palëve blerëse pjesën e mbetur të kuotave prej 10%, duke dalë përfundimisht nga kjo shoqëri. Kalimi i kuotave tek blerësit do të bëhet në respektim të parimit të ruajtjes së pjesëmarrjes në shoqëri, ku blerësit do të përfitojnë respektivisht nga 5% të kuotave të mbetura. Shitja e 10% të vlerës do të bëhet me vlerën e tyre nominale. Shitja e të gjitha kuotave, dhe dalja e shitësit nga kjo shoqëri, nuk do të ketë asnjë ndikim në të drejtat që rrjedhin nga neni 2 i kësaj kontrate, dhe sidomos në lidhje me përfitimin e vlerës së energjisë sipas përcaktimeve të bëra në nenin 2.1.b.

2.3.b. Përjashtimit, vetëm dhe vetëm në rast se, pas marrjes së lejës së shfrytëzimit, dhe fillimit të aktivitetit të HEC, shitësi refuzon që të transferojë 10% të kuotave tek blerësit, ky i fundit humbet të drejtat që rrjedhin nga neni 2.1.b, për përfitimin e vlerës së energjisë sipas përcaktimeve të kësaj dispozite.

2.3.c Në rast, se pas marrjes së lejës së shfrytëzimit, pala blerëse refuzon që të blejë kuotat, pala shitëse do të ruajë çdo të drejtë që rrjedh nga pronësia 10% e kuotave si dhe çdo të drejtë që rrjedh nga kontrata dhe veçanërisht, neni 2.1.b, 2.1.c, 2.1.d dhe 2.1.e i kësaj kontratë, duke përfituar vlerën e energjisë së prodhuar sipas parashikimeve të përcaktuara.

2.4 Nëse hidrocentrali vijon funksionimin për më shumë se 28 vjet, të njëjtat kushte, sanksione apo garanci, që janë përcaktuar për periudhën 28 vjeçare në këtë kontratë, aplikohen për periudhën e mëpasme, duke marrë për bazë treguesit

respektivë të periudhës. Pala blerëse, dhe në vijim shoqëritë "EAG" sh.p.k., dhe "MP-HEC" sh.p.k., do të çlirohen nga ky detyrim në rast se me kalimin e afatit 28 vjeçar, HEC do ti transferohet pronarit shtet. Në rast se, në përfundim të afatit 28 vjeçar, shteti do tu ofrojë blerësve, mbajtjen e HEC-it përkundrejt kryerjes së një pagese, znj. Anna Xheka, apo çdo i tretë që përfiton këto të drejta prej saj do të jetë i detyruar që të paguajë 10 % të vlerës, për llogari të shtetit, në të kundërt do të humbasë të drejtat që rrjedhin nga neni 2.1.b i kësaj kontrate. Pala shitëse, ka të drejtën që të zgjedhë nëse vlerën 10 % (pjesën e saj takuese) do ta kryerje menjëherë apo do kjo do ti mbahet nga të drejtat që rrjedhin nga neni 2.1.b i kësaj kontrate. Në rast se pala blerëse nuk është e interesuar që në përfundim të afatit 28 vjeçar, të mbajë përkundrejt pagesës/detyrimit ndaj shtetit, HEC-in " Niçe", kjo e fundit ka detyrimin që t'ia ofrojë kuotat e shoqërisë "MP-HEC" sh.p.k., shitëses Anna Xheka, duke u çliruar nga detyrimi i parashikuar në nenin 2.1.b.

Në çdo rast, për çdo përfitim të blerësve, që lidhet me transferimin e HEC-it tek shteti koncensionarit apo shoqërisë koncensionare, sipas paragrafit mësipër, shitësi përfiton pjesën e tij takuese.

NENI 3

Mënyra e Llogaritjes së Vlerës që do përfitohet nga Shitësi

- 3.1.a Vlera Bruto Mujore e Energjisë së Faturuar, përfaqëson vlerën e faturës mujore, që shoqëria koncensionare ia pret blerësit të energjisë elektrike, KESH (Korporatës Energjetike Shqiptare) apo çdo blerësi tjetër të mundshëm, shtetëror apo privat. Pala blerëse, dhe në vijim shoqëria "MP-HEC" sh.p.k, (te cilës do ti transferohet detyrimi) do të zbresë nga vlera e energjisë që do të përfitojë pala shitëse, tatimin e mbajtur në burim, tatim të cilin do ta paguajë për llogari të përfitueses, pranë organeve tatimore.
- 3.1.b Nëse, për faj të blerësit dhe/ose shoqërisë, "Energy Albania Group" sh.p.k dhe/ose "MP-HEC" sh.p.k, nuk ka filluar dhe/ose është ndërprerë prodhimi i energjisë elektrike, apo shoqëria nuk faturon energjinë e prodhuar, për të llogaritur detyrimin që i takon shitësit, sipas nenit 2.1.b të kësaj kontrate, do të merret për bazë prodhimi vjetor i energjisë sipas fuqisë së instaluar të miratuar dhe çmimi i shitjes së energjisë elektrike i vitit respektiv. Pala blerëse do të jetë e çliruar nga detyrimi i saj për të respektuar parashikimet e nenit 2.1.b të kësaj kontrate, vetëm dhe vetëm kur mos prodhimi i energjisë elektrike, apo ndërprerja e energjisë elektrike ka ardhur si rrjedhojë e forcës madhore, apo si rrjedhojë e shkaqeve që nuk varen nga kjo palë. Bëjnë përjashtim nga këto shkaqe të gjitha rastet kur blerësi, shoqëritë "Energy Albania Group" sh.p.k

dhe/ose "MP-HEC" sh.p.k, mund të shmangnin ardhjen e këtyre pasojave, sipas parashikimeve të nenit 7.1.b. Në rast të situatës së mësipërme përjashtimore, blerësi është i detyruar të kërkojë dëmshpërblim nga palët e treta shkaktare, dhe shitësi përfiton pjesën e tij proporcionale nga dëmshpërblimi, në momentin që ai do të përfitohet nga blerësi, Nga vlera e dëmshpërblimit do të zbriten porporcionalisht në raport me pjesën takuese të shitësit, shpenzimet e kryera, për përfitimin e këtij detyrimi, vetëm për pjesën e ngarkuar blerësit ose shoqërisë "MP - HEC" sh.p.k, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

- 3.1.c Nëse ka filluar prodhimi, dhe blerësi apo shoqëritë "Energy Albania Group" sh.p.k dhe/ose "MP-HEC" sh.p.k, gjenden në kushtet e shkëljes së nenit 2.1.b të kësaj kontrate, për të llogaritur detyrimin do të merret për bazë faturimi mesatar i 12 muajve të funksionimit, dhe në çdo rast kur HEC ka funksionuar më pak se 12 muaj, mesatarja e periudhës së funksionimit. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike është ai i vitit respektiv.
- 3.1.d Në rast se blerësi dhe në vijim shoqëria "MP-HEC" sh.p.k, pa pasur një shkak të arsyeshëm, sipas parashikimeve të kësaj kontrate dhe nenit 2.1.b, vonojnë deri në gjashtë muaj pagesën qoftë edhe të një fature të vetme, shitësi ka të drejtën që të kërkojë një parapagim të detyrimit deri në 3 vjet.

NENI 4

Mënyra e pagesës së detyrimit sipas nenit 2.1

4.1.a Detyrimi sipas kësaj kontrate është mujor. Ky detyrim është e ardhur neto për shitësin, pasi është zbritur prej tij tatimi i mbajtur në burim, i cili paguhet nga shoqëria "MP-HEC" sh.p.k në organet tatimore. Detyrimi do të paguhet këtij të fundit, në një llogari të deklaruar me shkrim prej tij, brenda datës 28 të muajit pasardhës. Çdo vonesë në mosrespektimin e këtij afati, sanksionohet me 14 000 (katërmëdhjetë mijë) Lek, ose ekuivalenti në Euro, penalitet për çdo ditë vonese.

NENI 5

Mënyra e Kalimit të Pronësisë së Kuotave

5.1.a Pala shitëse i kalon 90 % të kuotave të saj tek pala blerëse, me kryerjen e pagesës së vlerës nominale të tyre, në llogarinë bankare të caktuar nga shitësi, në të njëjtën ditë të nënshkrimit të kësaj kontrate. Me përmbushjen e shitjes së 90% të kuotave të shoqërisë " EAG" sh.p.k., blerësit i transferohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga këto kuota. Me nënshkrimin e kontratës, blerësit kane paguar vleren prej 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) Euro, në llogarinë e shoqërisë EAG sh.p.k., sipas parashikimeve të nenit 2.1.b. Kryerja e pageses ne


llogarine e shoqërisë "EAG" sh.p.k., do të verifikohet me konfirmin bankar që verifikon kryerjen e transaksionit.

- 5.1.b Pala shitëse do të kalojë 10% të kuotave të mbetura, në momentin e marrjes së lejës së shfrytëzimit të HEC-it, "Niçë", objekt i i kontratës së koncesionit e formës BOT nr. 311 Rep., 45 Kol., datë 02.02.2009, në vlerën e tyre nominale. Refuzimi për të kaluar kuotat tek blerësi zhvesh palën shitëse nga të drejtat e njohura në nenin 2.1.b të kësaj kontrate. Refuzimi i blerësit për të blerë këto kuota, nuk ka asnjë pasojë për palën shitëse, e cila veç përfitimit të të drejtave që do të vijë nga neni 2.1.b i kontratës, do të gëzojë edhe të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga 10% e kuotave.
- 5.1.c Pala shitëse nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi nëse shuma prej 250 000 Euro , bllokohet nga kreditorë të tretë, nga organet tatimore, apo nga institucionet ligjzbatuese. që kanë pretendime ndaj shoqërisë.

NENI 6

Detyrimet e Shitësit

- 6.1.a Shitësi garanton Blerësin që kuotat, objekt i kësaj kontrate, janë plotësisht të disponueshme, të transferueshme dhe të lira nga çdo lloj pengu, hipoteke apo barrë tjetër ligjore.
- 6.1.b Shitësi, deklaron me përgjegjësi të plotë se ai shet 90 % të kuotave të shoqërisë, të lira nga çdo detyrim, barrë, apo pretendim nga ndonjë palë e tretë.
- 6.1.c Shitësi deklaron me përgjegjësinë e tij të plotë se kuotat e tij (90% të kuotave të shoqërisë) dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre, nuk janë subjekt i asnjë procesi gjyqësor civil, penal, administrativ, apo asnjë procesi arbitrazhi jashtë apo brenda vendit.
- 6.2.a Shitësi garanton blerësin, në lidhje me vlefshmërinë e kontratës së koncesionit, në lidhje me vlefshmërinë e të gjithë dokumentacionit të paraqitur, për ndërtimin e HEC-it, për aq sa kjo vlefshmëri nuk lidhet me përgjegjësitë ligjore dhe institucionale të institucioneve të administratës publike. Shitësi garanton blerësin në lidhje me kryerjen në përputhje me procedurat dhe afatet ligjore të kërkesave, aplikimeve, kontratave në funksion të ndërtimit të hidrocentralit. Shitësi ka vënë në dijeni blerësin në lidhje me mos posedimin nga ana e këtij të fundit të "miratimit për zgjatjen e lejës së ndërtimit dhe ndryshimit të subjekteve ndërtuese", por garanton blerësin se ka aplikuar në kohë për zgjatjen e lejës dhe ndryshimin e subjekteve ndërtuese. Në zbatim të parimit të miratimit në heshtje, shoqëria ka lejen për të vijuar punimet edhe pse nuk e posedon fizikisht atë.



6.2.b Shitësi ka vënë në dijeni blerësin për mos kryerjen e raportimit 3 mujor mbi ecurinë e punimeve të Hec- it, pranë AKBN, si pasojë e ndërprerjes së punimeve për shkak të proceseve gjyqësore me ish – ortakun e “MP-HEC” shpk si dhe të shkresës Nr 845 Prot datë 15/01/2016 të AKBN shoqëruar me shkresën Nr 2 Prot, datë 19/01/2016 të shoqërisë “EAG” sh.p.k drejtuar AKBN. Në rast se ky fakt do të përbëjë shkak për mos përmbushjen e kontratës së koncensionit, përgjegjësia do të jetë e shitësit.

6.2.c Shitësi ka vënë në dijeni blerësin se afati i përfundimit dhe vënies në shfrytëzim të HEC-t, është brenda muajit dhjetor 2016, dhe blerësi do të aplikojë nëse do të jetë e nevojshme për zgjatjen e këtij afati.

6.2.d Në rast se mungesa e dokumentacionit, marrja e dokumentacionit të nevojshëm për ndërtimin e HEC-it do ta bëjnë të pamundur ndërtimin e tij, apo finalizimin e punimeve, pala blerëse do të jetë e çliruar nga detyrimet që rrjedhin nga neni 2.1.b.

6.2.e Blerësit garantojnë shitësen Anna Xheka, se ajo do të vijojë të jetë administratore, e shoqërive “ EAG” sh.p.k. dhe MP-HEC sh.p.k., për një periudhë jo më të shkurtër se vërtetimi i faktit, të marrjes së lejes së shfrytëzimit. Në cilesinë e administratores, znj. Anna Xheka ka të drejtën dhe detyrimin që të plotësojë përmbushjen e detyrimit që rrjedh nga neni 6.2.f.

Shitësja Anna Xheka është e gatshme të qëndrojë administratore e shoqërive “ EAG” sh.p.k. dhe MP-HEC sh.p.k, deri sa HEC-i të fillojë shfrytëzimin e tij dhe ka të drejtën dhe detyrimet që derivojnë nga neni 6.2.f. Shitësja Anna Xheka, për aktivitetin e saj si administratore nuk do të pretendojë asnjë kompensim.

6.2.f Administratorja, njofton ortakët e shoqërisë, nëpërmjet depozitimit të transaksioneve bankare, të transfertave në llogaritë e kreditorëve të shoqërisë, sipas mënyres të përcaktuar në këtë kontratë, për shlyerjen e detyrimit në masën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) Euro, që shoqëria “MP-HEC” sh.p.k ka ndaj të tretëve, me qëllim mbylljen e detyrimeve të mbetura që rezultojnë nga bilanci i vitit 2015 i shoqërisë “MP-HEC” shpk.

6.3.a Shitësi deklaron se shoqëria që zotëron apo ajo koncensionare nuk kanë asnjë detyrim ligjor të pashlyer, përveç detyrimeve të mbetura nga bilanci, në masën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) Euro, të cilin blerësi e njeh, si dhe detyrimin, sipas Njoftim Vlerësimit me Nr. Prot. 10487, dt 09.07.2013 , lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore – Korçë për periudhen tatimore : -Tatim fitimi për periudhën Viti 2012, në vlerën 1.676.258 Lekë, së bashku me kamatvonesat dhe interesat përkatëse deri në përfundim të procesit gjyqësor. Ky detyrim është detyrim i shoqërisë, do të shlyhet nga shitësi, duke u zbritur nga të ardhurat që ai do të realizojë nga të drejtat e njohura, sipas nenit 2.1.b të kësaj kontrate, vetëm



dhe vetëm nëse në përfundim të procesit gjyqësor respektiv, i cili është duke u Gjykuar ne Gjykatën e Lartë, vendoset rrëzimi i padisë dhe detyrimi mbetet në fuqi. Nëse Gjykata me një vendim përfundimtar të formës së prerë vendos pranimin e kërkesë padisë, shitësi nuk ka asnjë detyrim ndaj blerësit.

6.3.b Nëse gjatë apo mbas transferimit të kuotave, dalin detyrime të pashlyera, ato do ti ngarkohen shitësit, me kusht që detyrimi të ketë lindur në kohën kur kuotat e shoqërisë zotëroheshin nga shitësi, dhe është titull ekzekutiv.

Në të gjitha rastet kur detyrimi i pretenduar nga të tretët, ka lindur përpara nënshkrimit të kësaj kontrate, dhe është kërkuar pas nënshkrimit të saj, blerësi ka detyrimin ligjor që të njoftojë shitësin menjëherë sapo të bjerë në dijeni të pretendimeve të të tretëve, për ekzistencën e këtyre detyrimeve, duke i krijuar shitësit mundësinë që bashkë me një përfaqësues të shoqërisë, ai vetë dhe/ose një përfaqësues i zgjedhur prej tij, të përfaqësojë pa kufizim shoqërinë në këtë proces gjyqësor në të gjitha shkallët e gjykimit. Në çdo rast, kur plotësohet kushti i mësipërm dhe vërtetohet me vendim gjyqësor të formës së prerë, se detyrimet kanë lindur përpara kësaj kontrate, shitësi do të ngarkohet me shlyerjen e tyre, me dëmin e shkaktuar blerësit si rrjedhojë e këtyre detyrimeve, si dhe me shpenzimet procedurale për kundërshtimin e këtyre detyrimeve. Në çdo rast, këto detyrime do të mbahen nga vlera që do të kishte përfituar shitësi nga respektimi i të drejtës së tij që rrjedh nga neni 2.1.b i kësaj kontrate.

6.3.c Mbi shitësin nuk do të rëndojë asnjë detyrim, në rastet kur:

1) Blerësi nuk njofton shitësin me shkrim mbi pretendimet e të tretëve. Njoftimi i shitësit do të bëhet me postë, në adresën Anna Xheka, Rruga "Drejtësia" 7790 Durrës. Në rast se shitësi ndryshon adresën ai ka detyrimin që të njoftojë me shkrim blerësin, shoqëritë "EAG" sh.p.k. dhe "MP_HEC" sh.p.k., në lidhje me adresën e re. Njoftimi i blerësit do të bëhet në adresat e shoqërive të publikuara në QKR. Njoftimi do të konsiderohet i kryer në rast se nga konferma postare, rezulton se shitësi/blerësi/ shoqëritë "EAG" sh.p.k. dhe "MP_HEC" sh.p.k. kanë ndryshuar adresë dhe nuk kanë njoftuar adresën e re, dhe/ose kanë refuzuar marrjen e postës.

2) dhe/ose nuk i jep atij të drejtë përfaqësimi pa kufizim në të gjitha shkallët e ankimimit administrativ ose gjyqësor;

6.4.a Në rast se nga përmbajtja e dokumentacionit të shoqërisë, për të cilat shitësi ka ose duhet të kishte dijeni, rezulton se shitësi ka mbajtur të fshehta, apo në kushtet e keqbesimit nuk ka informuar blerësin në lidhje me; situatën financiare të shoqërisë, dokumentacionin ligjor të shoqërisë, mangësitë në dokumentacionin ligjor të nevojshëm për ndërtimin e Hec, deri në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate, apo çdo të metë që ka ekzistuar përpara lidhjes së kësaj kontrate, që

përbëjnë shkaqe që do të pas sillnin zgjidhjen e kontratës së koncesionit, dhe/ose pamundësinë për tu pajisur me lejët e nevojshme për ndërtimin e HEC-it, si dhe në çdo rast tjetër, kur provohet ekzistenca e dijenisë së të metave që pengojnë ndërtimin e HEC-it, blerësi do të çlirohet nga çdo detyrim që ai ka ndaj shitësit, dhe do ti kthehet shuma e paguar për shlyerjen e detyrimeve prej 250 000 euro, në rastin më të parë që do të shitet Hec me kushte jo më të disfavorëshme se kjo kontratë.

Blerësit dhe në vijim shoqëritë "EAG" sh.p.k. dhe "MP-HEC" sh.p.k., do të jenë të lirë nga detyrimi sipas nenit 2.1.b, në rast se ndërtimi dhe/ose funksionimi i HEC-it bëhet i pamundur si rrjedhojë e forcës madhore, dhe/ose shkaqeve që nuk varen nga vullneti i tyre, por jo në rastin kur, edhe pse nuk lidhen me vullnetin apo pakujdesinë e blerësit dhe/ose shoqërive "EAG" sh.p.k. dhe "MP-HEC" sh.p.k, mund të ishin shmangur nga këta të fundit, nëse do të kishte treguar kujdes maksimal, në menaxhimin dhe funksionimin e HEC-it.

Në rast se Blerësit dhe në vijim shoqëritë "EAG" sh.p.k. dhe "MP-HEC" sh.p.k., do ta kenë të pamundur ndërtimin e HEC-it si rrjedhojë e shkaqeve apo të metave që kanë ekzistuar përpara lidhjes së kësaj kontrate, dhe të cilat blerësit në vijim shoqëritë që marrin përsipër detyrimin, nuk kanë mundur që ti eliminojnë, keto të fundit do të jenë të çliuara nga detyrimet që rrjedhin nga neni 2.1.b.

NENI 7

Detyrimet e Blerësit

7.1.a Detyrimin që rrjedh nga përmbajtja e nenit 2.1.b të kësaj kontrate, blerësit dhe shoqëritë "EAG" sh.p.k dhe "MP-HEC" sh.p.k, ia njohin shitësit, dhe marrin përsipër që të kryejnë çdo veprim të nevojshëm, për t'ja paguar shitësit Anna Xheka, sipas parashikimeve të kësaj kontrate, për aq kohë sa të funksionojë hidrocentrali "Niçë", objekt i i kontratës së koncesionit i formës BOT nr. 311 Rep., 45 Kol., datë 02.02.2009, por jo më pak se 28 vjet. Përrjashtimisht pala blerëse do të çlirohet nga ky detyrim kur si rrjedhojë e një force madhore apo shkakut që nuk lidhet apo nuk mund të varet nga vullneti i blerësit, do të bëhet i pamundur funksionimi apo ndërpreja e veprimtarisë së HEC. Kur mosfunksionimi apo ndërprerja e veprimtarisë së Hec, vjen nga pakujdesia, keqmenaxhimi apo veprimet me faj të blerësit apo shoqërive "EAG" sh.p.k dhe "MP-HEC" sh.p.k, këta të fundit mbajnë të gjitha detyrimet e kësaj kontratë ndaj shitësit.

Në rastet kur si rrjedhojë e shkaqeve të parashikuara në këtë dispozitë, bëhet i pamundur funksionimi i përkohshëm i HEC, të drejtat e palës shitëse do të bëhen menjëherë të aplikueshme sapo të filloje funksionimi i tij.

Në rast të situatës së mësipërme përjashtimore, blerësi është i detyruar të kërkojë dëmshpërblim nga palët e treta shkaktare, dhe shitësi përfiton pjesën e tij proporcionale nga dëmshpërblimi, në momentin që blerësit, në vijim shoqërive që ju kalon detyrimi, do ta përfitojnë atë. Nga vlera e dëmshpërblimit do të zbriten proporcionalisht në raport me pjesën takuese të shitësit, shpenzimet e kryera, për përfitimin e këtij detyrimi, vetëm për atë sa janë ngarkuar shoqërive, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

- 7.1.b Përjashtimisht, pala blerëse dhe shoqëritë "EAG" sh.p.k dhe "MP-HEC" sh.p.k do të jenë të detyruar që ti paguajnë shitësit, vlerën e energjisë që do të ishte prodhuar, sipas përlogaritjeve të bëra në mënyrën e përcaktuar në këtë kontratë, në rastet kur shkaku i mos ndërtimi/funksionimit të HEC-it është rrjedhojë e shkaqeve që edhe pse nuk lidhen me vullnetin apo pakujdesinë e blerësit, mund të ishin shmangur nga ky i fundit, nëse do të kishte treguar kujdes maksimal, në menaxhimin dhe funksionimin e HEC-it.
- 7.1.c Pala blerëse dhe shoqëritë "EAG" sh.p.k dhe "MP-HEC" sh.p.k njohin të drejtat e palës shitëse sipas kësaj kontrate, si dhe të drejtën e shitësit për disponimin e këtyre të drejtave, transferimin e tyre tek të tretët, sipas vullnetit të shprehur me një deklaratë me shkrim, pa qënë e nevojshme marrja e aprovimit të palës blerëse. Të gjitha të drejtat e palës shitëse të njohura sipas kësaj kontrate janë të trashëgueshme, për pasardhësit në rradhë të shitësit, Znj. Anna Xheka, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.
- 7.2.a Çdo kontratë, shitje, dhurimi, trashëgimie apo çdo forme tjetër tjetërsimi, tërësore apo pjesore nga blerësit, tek palë të treta të mundëshme, si në rastin kur objekt i transaksionit janë kuotat e shoqërisë "ENERGY Albania Group" sh.p.k po ashtu edhe të transaksioneve të lidhura me kuotat e shoqërisë MP-HEC sh.p.k., si dhe çdo proces kalimi në likuidim, për të gjithë kohën e ekzistencës së HEC "Nicë", garanton detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë. Çdo ndryshim i mundëshëm i ortakëve të shoqërisë "ENERGY ALBANIA GROUP" sh.p.k apo shoqërisë koncensionare "MP-HEC" sh.p.k, e transferon automatikisht detyrimin, me kushtet e mësipërme tek ortakët e rinj. Në të kundërt çdo transaksion është i pavlefshëm.
- 7.2.b Të gjitha të drejtat që palës shitëse i njihen me anë të kësaj kontrate, veçanërisht e drejta për të përfituar vlerën e energjisë elektrike sipas koeficienteve dhe afateve kohore të përcaktuara shprehimisht këtu, rregjistrohen në ekstraktin e koncensionarit "EAG" sh.p.k dhe shoqërisë koncensionare "MP-HEC" sh.p.k në QKR dhe është publik për këdo që kërkon të dhëna për shoqërinë. Këto të drejta

lidhen dhe kufizohen vetem dhe vetem me prodhimin e energjisë elektrike nga HEC- "Niça", objekt i i kontratës së koncesionit e formes BOT nr. 311 Rep., 45 Kol., datë 02.02.2009 . Shitësi nuk ka asnjë të drejtë, mbi të ardhurat që do të realizojë shoqëria si rrjedhojë e aktiviteteve të tjera tregëtare, apo në rast se ajo do të ndërtojë HEC-e të tjerë, si dhe nuk ka asnjë të drejtë mbi të ardhurat që rrjedhin nga aktiviteti i saj tregtar në HEC-in "Niçë", i ndryshëm nga ai, objekt i i kontratës së koncesionit e formës BOT nr. 311 Rep., 45 Kol., datë 02.02.2009, kur këto të ardhura nuk gjenerohen nga shitja e energjise elektike.

7.2.c Palët kanë detyrimin që të kryejnë të gjitha veprimet për regjistrimin dhe realizimin e këtyre të drejtave në përputhje me parashikimet e bëra në këtë kontratë. Në të kundërt kjo do të konsiderohet shkelje e detyrimeve kontraktore nga këta të fundit dhe sjell për pasojë të drejtën e palës shitëse të zgjidhë kontratën dhe të kërkojë shpërblimin e dëmit . Gjithsesi rregjistrimi i këtyre të drejtave në QKR, nuk përbën kusht për aplikimin e këtyre të drejtave, në momentin e rregjistrimit, pasi ato bëhen të kërkueshme me fillimin e prodhimit nga ana e HEC.

7.2.d Në rast pezullimi/ ndërprerje të funksionimit të hidrocentralit "Niça", objekt i i kontratës së koncesionit e formes BOT nr. 311 Rep., 45 Kol., datë 02.02.2009, pala blerëse, e në vijim shoqëritë që do tu kalojë detyrimi, dhe me konkretisht "EAG" sh.p.k., e në vijim shoqëria "MP-HEC" sh.p.k., është e detyruar të paguajë detyrimin sipas kësaj kontrate, përjashtimit kur ndërprerja apo pezullimi ka ardhur si rrjedhojë e një force madhore, apo shkakut tjetër që nuk varet nga vullneti bleresit. Kur vërtetohet se pezullimi apo ndërprerja është rrjedhojë e veprimeve me faj, apo nga pakujdesia e bleresit përfshirë edhe keqmenaxhimin, (shiko nenin 7.2.b), atëhere pagesa do të bëhet normalisht sipas parashikimeve të kësaj kontrate.

7.3.a Blerësi dhe në vijim, shoqëria "MP-HEC" sh.p.k., e cila do të marrë përsipër detyrimin, njeh si të drejtë kreditore të shitësit znj. Anna Xheka, shumën prej 5 479 567 milion lekë të reja TVSH e rimbursueshme, për punimet e kryera nga shoqëria "MP-HEC" sh.p.k, sipas procedimit administrativ me Nr 74/21 Prot date 30.12.2015 te Drejtorisë Rajonale Tatimore Durres Kjo e drejtë bëhet e kërkueshme vetëm nëse ajo do te rimbursohet nga organet tatimore, apo do ti kthehet shoqërisë "MP-HEC" sh.p.k., në çdo formë tjetër, (përfshirë kompensimin e TVSH-se). Blerësi ka detyrim ta njoftojë Znj. Anna Xheka me shkrim brenda 3 ditëve nga rimbursimi apo kompensimi i kësaj shume. Brenda tre ditëve nga marrja e njoftimit, me shkrim shitësi Anna Xheka i komunikon shoqërisë llogarinë bankare ku do të bëhet kthimi i shumës, dhe shoqëria, i kalon

shitësit, brenda 5 ditëve nga kërkesa me shkrim që shitësi, Znj. Anna Xheka shumë në llogarinë e deklaruar prej saj. Për çdo ditë vonesë shitësi ka të drejtë të aplikojë një kamatvonesë prej 14 000 (katërbëdhjetë mijë) Lekë në ditë.

7.4.a. Blerësi, dhe në vijim, shoqëria MP-HEC sh.p.k., e cila do të marrë përsipër detyrimin, ka detyrimin në cilësinë e zotëruesit të 90% të kuotave të shoqërisë "EAG" sh.p.k., e cila është shoqëria mëmë e shoqërisë koncensionare "MP-HEC" sh.p.k, të autorizimit të shitësit Anna Xheka, për ngritjen e një padie gjyqësore me paditës "MP-HEC" shpk dhe të paditur RBAL dhe studios gjermane "DECON" , brenda 15 ditëve nga kërkesa me shkrim e shitësit, me objekt "Kthim shume prej 35 000 Euro dhe pagim dëmi", me kusht që shpenzimet e procesit të përballohen nga shitësi Znj. Anna Xheka. Blerësi gjithashtu njih si të drejtë kreditore të shitësit Znj. Anna Xheka, shumë prej 35 000 Euro, shumë e dëmit, si dhe shpenzimet gjyqësore, në momentin që kjo shumë apo çfardo shume që do të vendosë gjykata, do të rimburohet në llogarinë e shoqërisë, në zbatim të vendimit të pritëshëm të procesit gjyqësor të mësipërm, nëse do të fitohet çështja. Blerësi ka detyrim ta njoftojë Znj. Anna Xheka me shkrim brenda 3 ditëve nga rimbursimi i kësaj shume. Brenda tre diteve nga njoftimi me shkrim shitësi Anna Xheka i komunikon shoqërisë llogarinë bankare ku do të bëhet kthimi i shumës, dhe shoqëria, i kalon shitësit, brenda 5 ditëve nga kërkesa me shkrim që shitësi, Znj. Anna Xheka shumë në llogarinë e deklaruar prej saj. Për çdo ditë vonesë shitësi ka të drejtë të aplikojë një kamatvonesë prej 14 000 (katërbëdhjetë mijë) Lek në ditë. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet që do të rrjedhin nga ky proces gjyqësor i kalojnë shitësit, i cili sipas rastit parapaguan shpenzimet gjyqësore për hapjen e padisë, por edhe përfiton shpenzimet gjyqësore të njohura nga gjykata.

NENI 8

Procedura e Informimit

8.1.a Deri në datën 10 të çdo muaji, pala blerëse dhe/ose shoqëritë "EAG" sh.p.k dhe "MP-HEC" sh.p.k , janë të detyruar ti dërgojnë shitësit znj. Anna Xheka, apo trashëgimtarëve të saj, një kopje origjinale të faturës bruto së shitjes së energjisë elektrike të një muaji më parë, si dhe një fotokopje të faqes së librit të shitjes që deklarohet tek organet tatimore, apo çdo dokument tjetër të barasvlefshëm, në adresën e email: xhekaanna@gmail.com, ose në një adresë tjetër të njoftuar nga ajo, sipas parashikimeve të nenit 6.3.c.

Më kërkesën e shitësit, dërgimi i dokumentacionit të njesuar me origjinalin, me vulë dhe nënshkrim të njomë të shoqërisë "MP-HEC" sh.p.k, të shoqëruar me

një shkresë përcjellëse do të bëhet me postë në adresën e përcaktuar në nenin 6.3.c.

- Çdo vonesë në mosrespektimin e këtij afati, sanksionohet me 14 000 (katërmbëdhjetë mijë) Lekë, (ose ekuivalentin e saj në euro) penalitet për çdo ditë vonese.

8.2.b Shitësi Znj. Anna Xheka, apo trashëgimtarët e saj, apo palët e treta sipas parashikimeve të kësaj kontrate, pajisen me një autorizim të plotë dhe të parevokueshëm ligjor, brenda 10 ditëve nga fillimi i prodhimit të Hec, me anë të së cilit ka të drejtë të monitorojnë tek Hidrocentrali prodhimin e energjisë elektrike, apo kërkojnë informacion pranë blerësve të energjisë elektrike të prodhura nga Hec "Niça", qofshin këta shtetërorë apo privatë, si dhe institucioneve shtetërore apo private përkatëse, lidhur me vlerën mujore të faturuar të energjisë elektrike.

NENI 9

Legjislacioni i zbatueshëm dhe juridiksioni

Për aq sa nuk është parashikuar në këtë kontratë do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë që i referohen kontratës së shitjes për sa përputhen me objektin e kësaj kontrate, ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe dispozitave ligjore në fuqi.

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindi midis palëve, do të zgjidhet me bisedime dhe mirëkuptim të ndërsjelltë midis tyre dhe vetem kur nuk arrihet zgjidhja e çështjeve me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 10

Anekset e Kontratës

Pjesë përbërëse të kësaj kontrate janë:

- a. Vendimi i Asamblese se Pergjithshme te Ortakut të Shoqërisë "ENERGY ALBANIA GROUP" Sh.p.k., datë 30.05 .2016
- b. Vendimi i Asamblese së Pergjithshme të Aksionareve te Shoqërisë "Ghiggia Ingegneria d' Impianti", S.r.l, date 21.04.2016
- c. Vendimi i Asamblese se Pergjithshme te Aksionareve te Shoqërisë "ETRA" S.r.l, date 18.03.2016
- d. Kontrata e Konkensionit dhe dy shtesat e saj.
- e. Autorizimi nga Ministria e Energjise dhe Industrise.
- f. Deklaraten Noteriale, te dates 11.07.2016, Nr.
- g. Transferta Bankare e shumes 250 000 Euro, date 11.07.2016, sipas parashikimeve te nenit 5 te Kontrates.



NENI 11

Dispozita të Fundit

Kjo kontratë hartohet në gjashtë kopje të njëjta, ndër të cilat një kopje mbahet nga palët, një kopje depozitohet në Qendren Kombetare të Regjistrimit dhe një kopje pranë autoritetit kontraktues.

Z. Stefano Ghiggia dhe Z. Stefano Urbani rane ne dijeni te përmbajtjes se kësaj kontrate, nga përkthimi qe i është bere asaj ne gjuhen Italiane, nga Z. Genci Resuli, i cili deklaron se e njih këtë gjuhe.

Genci Resuli *Stefano Ghiggia*

PALET

SHITËSI

Anna XHEKA

BLERËSI

Shoqëria "Ghiggia Ingegneria d' Impianti", S.r.l,

Perfaqesuar nga Z. Stefano Ghiggia

STEFANO GHIGGIA

Ghiggia Ingegneria d' Impianti Srl

Partita IVA 0826790012

Amministratore Unico

Stefano Ghiggia

Shoqëria "ETRA" S.r.l,

Perfaqesuar nga

Z. Stefano Urbani

STEFANO URBANI


ETRA S.R.L.

Calle Seconda del Campiello, 7

30026 PORTOGRUARO (VE)

C. F./P. IVA/R. I. VE 03288000270

Cap. Soc. € 26.000,00 i.v



Notere

Sofika K. BRAKA



Branch MIS Code/ Kodi i Deges 000

KËRKESË PËR TRANSFERTE / TRANSFER REQUEST

Monedha & Shuma / Currency & Amount:

EUR	672,09
-----	--------

Shuma në fjalë/ Amount in words:

gjashtëqind e shtatëdhjetë e 09 s

Kursi i përdorur/
Foreign Exchange Rate used

Burimi i fondeve/ Source of funds:

Llogaria/Account: Kesh/Cash:

Datë valuta e kërkuar/ Requested Value Date:

- Standart /2 dite pune pas aplikimit
Standard/2 value dates
- 1 dite pune pas aplikimit/
1 value date
- Te njeten dite/
Same value date

Komisionet/Fees paid by:

- OUR Te gjitha nga paguesi/All by payer
- SHA Nga paguesi dhe perfituesi/
By payer and beneficiary
- BEN Te gjitha nga perfituesi/All by beneficiary

Deklarojme me pergjegjesi te plote se pagesa e mesiperme, buron nga aktivite te ligjshme dhe nuk perben veprim per pastrimin e parasave ose financimin e terrorizmit. Deklarojme se dokumentet e paraqitura nuk jane paraqitur me pare per te justifikuar transferat te tjera dhe pranojme se eshte detyrimi im/nye te sjellim ne bank dokumentat justifikues te pageses, ne origjinal ose kopje te noterizuar. Deklarojme se per cdo gabim kreditimi ose debitimi te llogarise apo per cdo parregullsi tjeter, Banka autorizohet te stornoje llogarine dhe ne rast mungese fondesh pranojme se do te rimbursuojme Banken me cdo shume te kerkuar nga ajo. Ne perputhje me Nenin 686 te Kodit Civil Shqiptar, Un/ve deklarojme shprehimisht se kemi lexuar, kuptuar dhe pranuar Kushtet e Pergjithshme te Biznesit si dhe Kushtet e Punes se Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.A dhe pranojme qe Banka ruan te drejten per te bere ne te ndryshime apo shtesa qe Banka 1 konsideron te nevojshme. Kam dijeni se banka nuk mban pergjegjesi per cdo gabim qe rrjedh nga udhezimet e gabuara te klientit, ose behet i pamundur zbatimi i date valutes se kerkuar. Per qellime te kryerjes se transferes se kerkuar nga ana ime/(jone), dhe ne zbatim te nenit 6 pika 1 shkronja "a" te Ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Per mbrojtjen e te dheneve personale" (Ligji), si dhe nenit 8 pika 2 shkronja "b" te Ligjit [nese kryerja e transferes se kerkuar nga ana ime/(jone) nenkupton perpunimin dhe transferimin e te dheneve personale te mia/(jona) me shtete qe nuk kane nivel te mjaftueshem te mbrojtjes se te dheneve personale] dhe dispozitave te tjera te aplikueshme te Ligjit, une/(ne) jap/(japim) pelqimin dhe autorizoj/(jme) Bankën për perpunimin e të dhënavë personale te mia/(tona), si dhe (sipas rasti) transferimin nderkombetar, me/tek perfituesi i transferes, dhe cdo subjekt i trete i kontraktuar apo nenkontraktuar, nga Banka dhe/ose banka e Perfituesit, me vendndodhje si brenda ashtu edhe jashte terriorit te Republikes se Shqiperise, per qellime te realizimit te kryerjes se transferes te kerkuar. Nepernjete ketij dokumenti, deklarojme se dokumentet, te dhënat dhe informacioni i mbledhur dhe i regjistruar nga Banka per qellime te identifikimit dhe verifikimit te identitetit, eshte i sakte dhe i perdituesuar. Per cdo ndryshim ne te ardhmen ne ndonje nga te dhënat te deklaruar apo dokumentet e identifikimit te dorezuar ne Banke, une/ne kam/kemi detyrimin t'i deklarojme dhe dorezojme ne Banke.

I/we declare under full responsibility that the above payment comes from legal activities and it does not represent a transaction or an action, which legally is considered by the proper authorities as money laundering or terrorism financing. I/we declare that the submitted documentation has not been presented before to justify other transfers and accept that is my our obligation to bring in the bank the accompanying documents of the payment, in original or notarized copy.

I we hereby declare that for any mistake in credit, debit or any other incongruity the Bank is authorized to reverse it unilaterally, and in the case of absence of funds i we accept that will reimburse the Bank with the entire amount required by it. According to Art. 686 of the Albanian Civil Code, we/ I declare that have read, understood and accepted the General Business Conditions and Terms and Conditions of the Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.A and accept the fact that the Bank retains the right to make changes or additions when necessary. I understand that the bank is not responsible for any mistake that occurs from wrong instructions given by me/us, or is unable to apply the value date requested. For the purpose of carrying out the transfer requested by me (us), based on article 6 section 1, letter "a" of the Law No. 9887, dated 10.3.2008 "On Personal Data Protection" (Law), as well as on article 8, section 2, letter "b" of the Law [if the carrying out of the transfer requested by me (us) includes elaboration and transferring of my (our) personal data in countries that do not have a sufficient level of personal data protection] and other applicable clauses of the Law, I (we) consent and authorize the Bank to elaborate my (our) personal data, as well as (as the case may be) to transfer internationally with to the transfer beneficiary, and any third party contracted or subcontracted by the Bank and/or the Beneficiary's bank, located within as well as outside the territory of the Republic of Albania, for the purpose of carrying out the requested transfer. By this document, i/we declare that the documents, data and any information collected and registered by the Bank, related to identification and my/our identity verification is accurate and updated. In case any change shall occur to any of the data or identity documents submitted in the bank, i/we must declare and provide them to the bank.

Emri i urdhëruesit/Ordering Customer <u>ETRA s.r.l</u>
Nr. i llogarisë së urdhëruesit / Ordering Customer's Account No <u>2069973530-1</u>
IBAN i urdhëruesit / Ordering Customer's IBAN -----
Emri i përfituesit/ Beneficiary <u>ENERGY ALBANIA GROUP SH.PK</u>
Adresa e perfituesit / Beneficiary's Address -----
Nr. i llogarisë së përfituesit/ Beneficiary's Account No <u>9833243530-1</u>
IBAN i përfituesit / Beneficiary's IBAN -----
Emri i bankës së përfituesit/ Name of Beneficiary's Bank -----
S.W.I.F.T – BIC CODE -----
Detajet dhe qellimi i veprimit/ Details and purpose of transaction <u>BLERJE KLIOTASH TE NGA ETRA, S.R.L DHE "GHEGHA"</u>
Burimi i fondeve/Source of funds -----

Klienti / Client

ETRA S.R.L

Banka /Bank

INTESA SANPAOLO BANK
Dega Tiranë

13